



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1282 Prot.

Tiranë, më 7.10 2019

VENDIM Nr. 220, datë 2.10.2019

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Neni 48 dhe VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 "Për miratimin e zonave arkeologjike "A" dhe "B", të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre" Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.11, datë 2.10.2019, pasi shqyrtoi Raportin e gjetjes arkeologjike rastësore "Strukturë muri në formën e një varri", zbuluar gjatë monitorimit të punimeve për projektin "Godinë banimi dhe shërbime 5 kate", rruga "Anastas Durrsaku", në zonën arkeologjike "B" Durrës- subjekti "JEDAS" sh.p.k. paraqitur nga shoqëria "K.A.E.XH" sh.p.k. si dhe konceptin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit për to, paraqitur nga individi i licencuar Z. Skënder Muçaj.

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e gjetjes arkeologjike rastësore "Strukturë muri në formën e një varri", zbuluar gjatë monitorimit të punimeve për projektin "Godinë banimi dhe shërbime 5 kate", rruga "Anastas Durrsaku", në zonën arkeologjike "B" Durrës- subjekti "JEDAS" sh.p.k., paraqitur nga shoqëria "K.A.E.XH" sh.p.k., si dhe konceptin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit për to, paraqitur nga individi i licencuar Z. Skënder Muçaj.
2. Të kryhet gërmimit arkeologjik i shpëtimit për pjesën e mbetur të sipërfaqes së projektit, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe të lidhur me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizojë këtë gërmim, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt. Raporti i tij do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Subjekti "JEDAS" sh.p.k., duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

OLEA MARGARITI
MINISTRE



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al